

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 96/19 dhe 110/19), si dhe në bazë të nenit 22 dhe neni 25 të Ligjit për arsim të mesëm („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/18), ministri i Arsimit dhe Shkencës e përcaktoi programin mësimor të shkurtuar për lëndën mësimore *Arti muzikor*, lëndë zgjedhore për vitin III (e tretë) për arsimin e mesëm - gjimnaz, për vitin shkollor 2020/2021.

1. Hyrje

Programi mësimor i shkurtuar për lëndën *Arti Muzikor* lëndë zgjedhore për vitin III (e tretë) për arsimin e mesëm në gjimnaz, bazohet në qëllimet/ rezultatet e pritura të parashikuara me programin mësimor për lëndën mësimore që rregullisht realizohet në përputhje me planin mësimor.

Me programin e shkurtuar përcaktohen njësitë e caktuara dhe njësitë mësimore që duhet të realizohen në 159 ditë mësimore, gjatë së cilës duhet të merret parasysh fondi javor i orëve të caktuara në programin e rregullt, përkatësisht për lëndën mësimore me 2 orë në javë parashikohen 64 orë në programin e shkurtuar me kohëzgjatje të orës mësimore prej 35 minuta.

Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, nocionet e caktuara, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

2. Pasqyra e temave dhe tërësive tematike

Tema/Fusha

1. FOLKLORI MUZIKOR

Tërësitë tematike

1 – Harta etno muzikore e Republikës së Maqedonisë;

2 – Instrumentet popullore;

3 – Etno kultura – veshja, zbukurimi dhe qëndisja;

4 -Punëtorja etnomuzikore.

Tema/Fusha

2. DËGJIMI I MUZIKËS

Tërësitë tematike

- Dëgjimi i muzikës

Tema/Fusha

3. VEPRAT MUZIKORE- SKENIKE 8 orë

Tërësitë tematike

- Veprat muzikore skenike

Tema/Fusha

4. INSTRUMENTET MUZIKORE

Tërësitë tematike

1 – Instrumentet me hark;

2 – Instrumentet frymore;

- 3 – Instrumentet me tel;
- 4 – Instrumentet me dridhje;
- 5 - Instrumentet me goditje.

3.Rekomandimet didaktike

Programi mësimor i shkurtuar për lëndën Arti muzikor për vitin III (e tretë) për gjimnaz do të realizohet për 159 ditë në vitin shkollor 2020/2021 në 64 orë mësimore në kohëzgjatje të orës mësimore prej 35 minuta. Në këtë program nuk është dhënë numri i orëve dhe përmbajtjeve, për arsye se vetë përmbajtjet dalin nga tërësitë tematike dhe qëllimet konkrete, si dhe në programin e rregullt mësimor, me çka i jepet mundësia mësimdhënësit të shprehë kreativitetin e tij dhe përshtatjen ndaj kushteve materiale-teknike dhe hapësinore, aktiviteteve të ndryshme dhe përshtatjen e mësimit me gjendjen e jashtëzakonshme në korniza botërore të krijuar nga virusi Kovid-19.

Në përpilimin e planifikimeve për realizimin e programeve mësimore për lëndën mësimore arti muzikor, lëndë zgjedhore për vitin III (e tretë) në arsimin e mesëm -gjimnaz, nuk është paraparë qasja e unifikuar. Nevojitet që secili mësimdhënës individualisht të bëjë gërshetimin e përmbajtjeve mësimore të temave të ngjashme dhe të ndryshme sipas nevojave reale për realizimin e mësimit, njëkohësisht duke pasur kujdes në lidhshmërinë logjike të tyre mes veti. Rekomandohet mësimdhënësi gjatë realizimit të orës mësimore në të cilën ka të integruar dy ose më shumë përmbajtje mësimore të ketë kujdes në vëllimin e materies mësimore.

Mësimdhënësi në planifikimin dhe realizimin e njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga qëllimet/rezultatet e pritura, konceptet e caktuara, metodat dhe aktivitetet të caktuara në mësimin e programit rregullt, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e mësimit prej 35 minutash. Ndjekjen e të arriturave të nxënësve secili mësimdhënësi individualisht duhet ta integrojë në kuadër të orëve të planifikuara për realizim, duke përdorë metoda, teknika dhe instrumente të ndryshme.

4. Normativi për kuadrin mësimor

Programin mësimor të shkurtuar e realizon mësimdhënësi në përputhje me normën për kuadrin mësimor të dhënë në programin mësimor të rregullt.

Programin mësimor të shkurtuar për lëndën arti muzikor lëndë zgjedhore për vitin III (e tretë) në arsimin e mesëm – gjimnaz, e përcaktoi

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

Milla Carovska
